



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400492/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandojmë rishqyrtimin e masës së pensionit të pleqërisë të shtetasit M.T.*

Drejtuar : **Z. Arsim RAMA**
Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve
Shoqërore

TIRANË

Zoti Drejtor,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi M.T, lidhur me mosmarrje të përgjigjes për kërkesën tij për rishqyrtim të masës së pensionit të pleqërisë.

Sipas shpjegimeve të tij, ankuesi lidhur me pretendimet për llogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë, që më datë 26.12.2013 ka depozituar pranë Institucionit tuaj një kërkesë për rishqyrtim pensioni, kopje të së cilës po jua dërgojmë bashkangjitur. Edhe pas interesimit të vazhdueshëm, shtetasit M.T nuk i është kthyer asnjë përgjigje zyrtare.

Duke e konsideruar këtë çështje si shkelje të të drejtave të ligjshme të tij, ankuesi ka kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit për të mundësuar rishqyrtimin e masës së pensionit të pleqërisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë*

rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se : “Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË:

Rishqyrtimin e masës së pensionit të pleqërisë të shtetasit M.T.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se;

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet të shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj ktij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT
Igli TOTOZANI

Me Urdhër dhe me Porosi
ND/KOMISIONER
Frederik PASKALI